



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:035826

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05460570

P.nr.44/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit T (P) M, nga fsh. R. K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprave penale, „Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 të KPRK-së, për shkak të kryerjes së veprës penale „Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr.21/2023, të datës 27.02.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 05.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit T.M dhe mbrojtësit të tij av. Prenk Palushi, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 05.03.2024, të njëjtën ditë gjykata shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 15.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

T. M, i lindur me fsh. R. K. Klinë, ku dhe tani banon, i biri i P dhe nënës Z e vajzërisë P, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i martuar baba i pesë fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal....., i nacionalitetit shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

1.Me datën, rreth orës min. Në fsh. L, K. K, përdor armë në mënyrë kërcënuese në dëm të të dëmtuarit K. C, në atë mënyrë qe pas një mosmarrëveshje në mes të dëmtuarit me të pandehurin, lidhur me një borgj, ky i fundit merr armën ..., shkon para shtëpisë së të dëmtuarit dhe me te në mënyrë kërcënuese shtënë 18 herë në drejtim të ajrit, ndërsa një predhë e godet në dritaret e shtëpisë së të dëmtuarit dhe më pas i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes.

Me çka ka kryer vepër penale „përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm “ nga neni 367 par.2 të KPRK-së,

2. Me dt, rreth orës min. Në fsh. L. K. K, me anë të armës, i shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve dhe të dëmtuarit K. C, dhe familjareve të tij, në atë mënyrë qe pas një mosmarrëveshje mes të dëmtuarit me të pandehurin, lidhur me një borgj, ky i fundit merr armën AK-47 shkon para shtëpisë së të dëmtuarit dhe me te shtënë 18 herë në drejtim të ajrit gjersa një predhë e godet një dritare të shtëpisë së të dëmtuarit, për çka shkakton rrezik të madh për jetën e të dëmtuarit dhe familjareve të tij, bashkëshortes P. C, dhe më pas i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes.

Me çka ka kryer vepër penale „Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm “ nga neni 356 par.1 të KPRK-së,

3. Nga koha e pacaktuar e gjerë me dt. ..., rreth orës min. Në fsh. L. K. K, mbanë në pronësi Armë në shkelje me ligjin për armët neni 5 par. 1 dhe ate një armë ... me nr. me një karikator dhe .. fishek te kalibrit mm, në atë mënyrë qe pasi i pandehuri siguron armën e lartëcekur të njëjtën e posedon pa leje gjerë me dt., kur e kryen veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e par dhe të dytë të kësaj aktakuze dhe më pas arma i sekuestrohet nga policia e Kosovës.

Me çka ka kryer vepër penale „Mbajtje në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve ng neni 366 par.1 të KPRK-së,

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 367 par.2, nenit 356 par. 1 dhe nenit 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

GJYKON

Të pandehurin: T. M,

Sipas dispozitivin -I- gjykata i përcakton Dënim me Gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) €, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

Sipas dispozitivit -II- me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

Sipas dispozitivit -III- gjykata i përcakton dënim me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) Euro.

ME DËNIM UNIK

Konform nenit 76 par. 2 nën par 2.4 të KPRK-së,

Dënohet me DËNIMI ME GJOBË në shumën prej 2000 (dymijë) €, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj me katër (4) këste, në afat prej gjashtëmbëdhjetë (16) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuar, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim duke e llogaritur 20 (njëzet) Euro për një ditë dhe:

DËNIM ME KUSHT

III.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (dy) viteve nuk kryen vepër të re penale.

IV. Dënimi me kusht do t'i revokohet konform nenit 50 të KPRK-së, nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vite.

V.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompenzim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, euro, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjet) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

VI.Konfiskohen: Konform nenit 235 par. 1 nën. par 1.9 të KPRK-së, lidhur me nenin 366 par. 3 të KPRK-së: Një (1) AK-..., nr....., me një karrikator; Tetëmbëdhjetë (18) gëzhoja kal.mm; Një (1) pjesë e predhës së fishekut; Një (1) mbështjellës i predhës së fishekut; dhe pesë (5) fishekë mm.

VII.UDHËZOHET: Pala e dëmtuar K. (P) C,nga fsh. L. K.K, rr. „n M” qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr. 21/2023 të datës 27.02.2023 kundër të pandehurit T (P) M, nga fsh. R. K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprave penale, „Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 të KPRK-së, për shkak të kryerjes së veprës penale „Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së. Duke i propozuar gjykatës qe pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.05.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari T. M si dhe mbrojtësi av. Prekë Palushi.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barë, me vërejtje për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaron se shpreh pendesë për veprën penale të kryer.

Gjykata ka gjetë se i pandehuri ka arritë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, të cilën e konfirmoj edhe në seancë se e ka arritë marrëveshjen në prokurori për pranimitë fajësie.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri pranon fajësinë, i njëjti është mbështetur edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe ky pranimitë fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, i propozoj gjykatës që të pranon pranimitë e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit T. M, Av. Prenk Palushi ka deklaruar se qëndroj në tërësi pranë marrëveshjes për pranimitë të fajësisë në Prokurori, duke i propozuar gjykatës se të njëjtën ta pranon me arsyetimin se me bindje të plotë, i pandehuri pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimitë të fajësisë, marrëveshjen për pranimitë e fajësisë e ka bërë vullnetshme pa kurrfarë ndikimi nga jashtë, mashtrim apo lajthim, marrëveshja për pranimitë fajësie mbështetet në faktet dhe provat në të cilat mbështetet aktakuza.

Theksoje se marrëveshja për pranimitë fajësisë nuk bie nënesh me dispozitat ligjore të nenit 242 të KPRK-së, dhe se e njëjta është arritur duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 70 të njëjtit Kod, përkatësisht duke u marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese nga i pandehuri, duke përfshirë pranimitë e fajësisë, akt pajtimin e të dëmtuarit, faljen e borxhit kontestuese ndaj të të dëmtuarit, pendimin për veprat e kryera, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të ngjashme penale, si dhe sjelljen e kryerësit pas kryerjes së veprave penale, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtën ta pranon përmes aktvendimit. I propozoj gjykatës që duke marrë për bazë gjendjen e vështirë ekonomike familjare të të pandehurit si mbajtës i vetëm i familjes 8 anëtarësh, të cilës i siguron ekzistencën materiale përmes një pensioni të Veterani të Luftës prej 150 euro, si dhe

përfitimet nga puna e krahut, konform dispozitave ligjore të nenit 44 të KPRK-se, dënimi me gjobe deri në shumë deri në 2000 euro ta obligoj të pandehurin të paguaj përmes 4 kësteve brenda 2 viteve, shpresoj që gjykata do ta ketë në konsideratë këtë kërkesë të pandehurit.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se sipas tekstit të marrëveshjes për pranimit të fajësisë për veprën penale të parapare si në dispozitivat e aktakuzës, të dënimi me burg ku është pra dënimi prej 10 muajve dënimi me kusht, beje plotësimin e marrëveshjes ashtu që dënimi i parapare të jete minimumi 7 muaj dhe maksimumi 10 muaj. Për veprën penale të parapare në dispozitivin 2 është parapare dënimi me 6 muaj burg me kusht minimumin, ndërsa maksimumi 9 muaj.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari, ka bërë marrëveshje për pranimit fajësie edhe në prokurori, gjë të cilën e pranoj edhe në gjykatë, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprat penale, „Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 të KPRK-së, për shkakt të kryerjes së veprës penale „Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprat penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprat penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe pendimin e tij, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri, më parë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, e poashtu prej këti rasti nuk ka kryer vepër tjetër penale, si dhe premtimin se nuk do të përsërisë më vepra penale.

I pandehuri ka deponuar në gjykatë dëshminë- Akt Pajtimin që e ka bërë me palën e dëmtuar K (P) C, me dt. i cili është bërë nga ana e të pandehurit dhe të dëmtuarit, ku i dëmtuari K. C, i cili hjek dorë nga ndjekja penale dhe nga kërkesa pasurore juridike, ndërkaq edhe akt pajtimi është një ndër rrethanat lehtësuese e të pandehurit.

Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale si dhe rrezikshmërinë e kryerjes së veprave penale, si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, konform nenit 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.44/2023 me datë 15.03.2024

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.